8	Ulja e frezës me anë të coil tubing për frezimin me qarkullim të jet pompës dhe ankoruesit Pas frezimit ulja më poshtë me qarkullim me coil tubing në ball të hapur. Kapja e fundit të pusit De-mobilizimi i mjeteve coil tubing, pajisjeve dhe personelit	1
9	Mobilizimi dhe instalimi pranë grykës së pusit të pajisjeve të karrotazhit Kryerja e matjeve për integritetin e kollonës, gurit të çimentos si dhe matjeve Karbon-Oksigjen	2
10	De-mobilizimi i mjeteve të karrotazhit, pajisjeve dhe personelit	1

11	Do të instalohet dhe ulet në pus kompletimi i tubove pompë-kompresor për vënien e pusit në shfrytëzim.	1
12	Vënia e pusit në zhfrytëzim dhe monitorimin e parametrave	1
13	De-mobilizimi i sondës, pajisjeve dhe personelit	1

Afatet e ekzekutimit: 2 (dy) muaj nga koha e fillimit të punimeve.

Shënim: Në rastet kur gjatë punimeve në pus nga kontraktori do të dalin problematika të paparashikuara në Programin e Punës, do të behet shtesë Programi Pune dhe shtyrje afati të punimeve i hartuar nga Q.P.N. Fier dhe i miratur nga Dega Teknike në administratën e Albpetrol Sh.A.

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Shoqëria "Albpetrol" Sh.A., ka nën administrim vendburime për nxjerrjen e naftës dhe gazit. Procedurat e remontit nëntokësor në pusët e pjesës më të madhe të këtyre vendburimeve shoqëria i kryen me mjetet e saj (Traktorë pastrimi, Autosonda diessel, autosonda elektrike, autongritës elektrik etj.).

Në vendburimin Cakran-Mollaj ndodhet pusi Ca-58 i cili është në avari të rëndë që prej muajit Gusht 2014, kur vendburimi Cakran-Mollaj ka qënë nën administrimin e kompanisë Stream Oil&Gas. Natyra e avarisë është se ka mbetur i kunjosur (Packer) në thellësinë $H = 2458.8$ m duke bllokuar komunikimin shtresë-pus dhe duke e nxjerrë jashtë funksioni pusin.

Punimet e fundit të kyera në pus për eliminimin e avarisë datojnë në periudhën nga data 08.06.2017 deri më datë 05.01.2018 duke harxhuar më shumë se 350 orë punime me autosondë ≥ 70 Ton por pa rezultat sepse pusi vazhdon të jetë i bllokuar. Pas punimeve të fundit rezulton se në pus ndodhet 1 tubo 2-7/8", 1 peco tubo 1.5 m deri 2 m, trupi i jetit dhe packeri 5". Gjithashtu seksioni i bllokuar nga packeri rezulton me mbetje mekanike që e bëjnë të vështirë punën e remontit në kushte normale.

Prodhimi mesatar ditor i pusit para se të binte në avari ka qënë:

2013		2014	
Muaji	Q (Ton/Ditë)	Muaji	Q (Ton/Ditë)
Janar	9.29	Janar	7.05
Shkurt	9.49	Shkurt	8.99
Mars	11.26	Mars	6.46
Prill	9.59	Prill	6.42
Maj	11.3	Maj	1.47
Qershor	9.21	Qershor	4.99
Korrik	9.3	Korrik	0
Gusht	7.55	Gusht	0
Shtator	7.76	Shtator	0
Tetor	9.24	Tetor	0
Nëntor	9.05	Nëntor	0
Dhjetor	9.96	Dhjetor	0

Eliminimi i kësaj avarie duhet të jetë prioritet për shoqërisë Albpetrol Sh.A., pasi koha e gjatë e kaluar në qetësi nga pusi mund vetëm të rrisë prodhimin (Ton/ditë) dhe cilësinë (% e ulët e H_2O si pasojë e ndarjes së mirë të fazave nga qëndrimi për një kohë të gjatë në qetësi) e naftës. Në qoftë se pusi do të vihet në shfrytëzim me kushte normale mendohet të japi një prodhim mesatar ditor prej minimalisht 8 Ton/Dita.

Për shkak të natyrës së vendburimit dhe natyrës së avarisë (Ku ndërhyrja më e fundit që mund të bëhet në këtë pus për eliminimin e avarisë është frezimi i packer-it.), punimet për eliminimin e kësaj avarie kërkojnë autosondë me kapacitet ≥ 80 Ton.

4. HISTORIKU I PUSIT DHE KONSTRUKSIONI

Pusi Cakrani-58 është vendosur në një sipërfaqe midis puseve Ca-67; Ca-55 dhe Ca-65 i cili ndodhet në pjesën kulmore të strukturës së Cakranit.

Pusi është shpuar sipas konstruksionit të mëposhtem:

Kuota nga niveli i detit-276.6 m

Konduktori Ø16"-51 m

Kollona e shfrytëzimit Ø 6 5/8"-1225.95 m, N-80 10.59 mm. Lartësia e çimetimit 200 m

Bisht Kollona Ø5"-1903 m. Intervali 1076.78 m -2980 m. Lartësia e çimetimit-500 m

Ball i hapur në gëlqeror-67 m

Fundi i pusit-3047 m

Tavani i gëlqerorëve-2976 m

Ka qenë në shfrytëzim nga Dhjetori i vitit 1986 deri në Shkurt 2014.

Me pas, si pjesë e regjimit të shfrytëzimit të pusit u instalua një jet-pompë, ku dhe kaloi në avari

Si rezultat i kësaj avarie kanë mbetur brenda në pus jet-pompa së bashku me valvule, ankoruesi si dhe 2 copë tubo Ø 2 7/8"

Në këto kushte më datë 01.02.2017 pusi kaloi nën administrim të shoqërisë Albpetrol Sh.A., icili tentoi për likuidimin e avarisë dhe për këtë qëllim u kontraktua një operator privat.

Pas hartimit të një programi pune dhe të miratuar filluan punimet për likuidimin e avarisë nga periudha 08.06.2017 deri më 05.01.2018

Punimet që janë kryer për likuidimin e avarisë gjatë kësaj periudhe kanë qenë si më poshtë:

- Larja e fundit të pusit me qarkullim me agregat nga papastërtitë dhe grimcat e grumbulluara
- Ulja e peshkatores Ø 2 7/8" M, tip lim me instrument 2 7/8" M.
- Tentativë për peshkimin e pajijseve të mbetura në pus-rezultat negativ
- Ulja e stampës Ø 100 mm e cila tregoi një manikotë tubo Ø 2 7/8"
- Ulja e peshkatores Ø 2 7/8" M, tip lim. Pas peshkimit dolën 2 copë tubo Ø 2 7/8" të rregullta duke lënë përsëri prezencën e manikotës së tubos Ø 2 7/8".
- U ul përsëri peshkatorja Ø 2 7/8" M, tip lim, u përsërit procesi i peshkimit - rezultati negativ. Peshkatorja doli e dëmtuar në fileta.

Konsultim në Albpetrol me grupin inxhiniero-teknik për vazhdimësinë e operacioneve

- Ulja e peshkatores me kunja - Nga ulja rezultoi që trupi i jet-pompës nuk ishte i instaluar në tubon e radhës pasi u kalua gjatësia e pecos prej 1.5 deri në 2 m
- Kjo e dhënë jep informacionin që në pus kanë mbetur 1 tubo e plotë Ø 2 7/8"; 1 peco 1.5 deri 2 m; jet-pompa dhe packeri Ø 5"

Konsultim në Albpetrol me grupin inxhiniero-teknik për vazhdimësinë e operacioneve

- U vendos që të furnizohet pusi me 30 copë tubo rënduese Ø 89 mm, për mundësinë e shkatërrimit të kunjave të packerit me goditje.
- Me tej u ul manovra poshtë, u krye qarkullim tek koka e tubos së mbetur në pus për pastrimin e mbeturinave të skorjeve, etj. U realizua disa herë goditje lartë-poshtë por nuk u verejt evancim më poshtë.
- Mbi bazën e relacionit të punimeve u krye konsultë në Albpetrol dhe u konstatua se: Shoqëria Albpetrol Sh.A. dhe operatori privat nuk i kanë kapacitetet e nevojshme teknike-teknologjike për vazhdimin e mëtejshëm të punimeve për eliminimin e avarisë dhe të ndërpriten punimet.
- U nxorën te gjitha pajisjet të ulura në pus.
- Në pus u ulën 177 copë tubo PK Ø 2 7/8" TS me manikotë të tornuar në fund të tyre dhe 73 copë tubo PK Ø 3 1/2" TS për mundësinë e riaktivizimit të pusit me ulje niveli me kompresor e cila nuk u krye për arsye së kompresori UKP-80 ishte me difekt.

5. OBJEKTIVAT DHE PERMBLEDHJA E PROGRAMIT TË PUNËS

2.1 OBJEKTIVI: Peshkimi ose frezimi i tubove, jet-pompës si dhe packerit të mbetur në pus.

2.2 PUNIMET QË PARASHIKOHEN TË KRYHEN NË PUS PËR ARRITJEN E KOMUNIKIMIT SHITESË-PUS DHE VENDOSJA E PUSIT NË SHFRYTËZIM

1. Hapja e rrugës dhe përgatitja e sheshit të pusit për ardhjen dhe instalimin e sondës si dhe pajisjeve të saj.
2. Përgatitja e grykës së pusit së bashku me valvulat dhe linjat e duhura te mbytjes dhe fakelit
3. Të provohet gadishmeria e tyre duke përfshirë edhe testimin me presion deri në 200 bar
4. Përgatitja e linjave të tjera sipërfaqësore për në depo, apo grupin e prodhimit.
5. Vendosja e pajisjeve të sigurisë si drejtues erë, pika e grumbullimit
6. Mobilizimi i sondës, pajisjeve dhe personelit sipas planit të përcaktuar
7. Ngritja e sondës dhe instalimi i pajisjeve të duhura
8. Mbushja e depove me fluid te mjaftueshëm për shkarkimin e gazit të tubingut dhe kezingut, si dhe për mbytjen e pusit në rastin më të keq.
9. Instalimi i pompës së sondës ose agregatit për qarkullim ose mbytjen e pusit
10. Shkarkimi në depo i presioneve të tubingut dhe kezingut. Monitorimi për gaze për rreth 2-3 orë
11. Pasi të konfirmohet që pusi është i vdekur të bëhet mbushja e plotë e tij me fluid (ujë)
12. Instalimi i preventorit së bashku me fllanxhën e punës mbi grykën e pusit dhe testimi për funksionalitetin e tij.

-
13. Testimi me presion i preventorit në 350 bar për 5 min dhe 200 bar për 10 min. Shkarkimi i presioneve.
 14. Nxjerrja e tubove pompë kompresor nga pusi 177 copë Ø 2 ^{7/8}" TS + 73 copë Ø 3 ^{1/2}" TS dhe matja e tyre, si dhe të furnizohet pusi me tubo Ø 2 ^{7/8}" PK në gjatësinë e nevojshme për arritjen e fundit të pusit në H = 3047 m.
 15. Ulja e stampës për të verifikuar thellësinë e kokës së tubos të mbetur në pus, si dhe konfiguracionin e pjesës së sipërme.
 16. Ulja me tubo e dy pastruesve (scrapers) njëkohësisht për pastrimin e mureve të brendshme të kollonës së shfrytëzimit Ø 6 ^{5/8}" dhe Ø 5" dhe qarkullim për pastrimin e mbetjeve asfaltene të pusit.
 17. Të kryhen matje gjeofizike për kontrollin e integritetit të kollonës së shfrytëzimit Ø 6 ^{5/8}" dhe 5".
 18. Mobilizimi dhe instalimi pranë grykës së pusit të pajisjeve të Coil Tubing.
 19. Instalimi dhe ulja me ngadale me anë të coil tubing të prerësës së metalit dhe peshkatores kambanë
 20. Ulja me ngadale në metrat e fundit që mendohet se pajisja prerëse është duke hyrë brenda tubove në pus.
 21. Pas përcaktimit të vendit ku do të pritët vendosja e pusit në qarkullim për pastrimin e fundit të pusit
 22. Prerja me qarkullim i tubos së bashku me pecon dhe sjellja e tyre lartë
 23. Nëse rezultatet nuk janë ato të pritshme të ripërsëritet procesi i prerjes si më parë.
 24. Ulja e frezës me anë të coil tubing për frezimin me qarkullim të jet pompës dhe ankoruesit
 25. Pas frezimit ulja më poshtë me qarkullim me coil tubing në ball të hapur
 26. Kapja e fundit të pusit
 27. Pasi të sigurohemi se i gjithë frezimi ka mbaruar dhe me anë të matjeve konfirmohet që është kapur fundi i pusit atëherë ngrihemi lartë
 28. De-mobilizimi i mjeteve coil tubing, pajisjeve dhe personelit
 29. Mobilizimi dhe instalimi pranë grykës së pusit të pajisjeve të karrotazhit
 30. Kryerja e matjeve për integritetin e kollonës, gurit të çimentos si dhe matjeve Karbon-Oksigjen
 31. De-mobilizimi i mjeteve të karrotazhit, pajisjeve dhe personelit
 32. Sipas kërkesave nga shoqëria Albpetrol Sh.A., me anë të sondës së shërbimit do të instalohet dhe ulet në pus kompletimi i tubove pompë-kompresor për vënien e pusit në shfrytëzim.
 33. Vënia e pusit në zhfrytëzim dhe monitorimin e parametrave
 34. De-mobilizimi i sondës, pajisjeve dhe personelit

6. Mjeti që do të kryejë punimet në pus duhet të plotësojë kushtet si më poshtë:

d) Termat e referencës:

II) Specifikimet për personelin;

- Brigadier, Manovrator, dy Përgjegjës Kyçi, dy Përgjegjës Fushe.
- Brigada e punës që do të kryejë operacionet hidrokarbure me autosondë duhet të jetë e përbërë nga: Manovratori, përgjegjësit e kyçit (Punonjësit e bazës), punonjësit e fushës, brigadieri dhe drejtuesi teknik i punimeve i cili duhet të jetë inxhinier naftë, dhe të jetë i pajisur me Certifikatën e Lejes Profesionale.
- Brigada e remontit duhet të jetë me eksperiencë jo më pak se 3 vjet në punimet e remontit nëntokësor të kërkuar nga Albpetrol Sh.a në këtë dokument.
- Sonda së bashku me brigadën do të punojë jo më shumë se 12 orë në ditë dhe në asnjë rast natën.
- Kontraktori do të marrë masa të respektojë kodin e punës qoftë përsa i përket orarit të punës qoftë përsa i përket respektimit të rregullave të sigurimit teknik dhe sigurisë në punë.
- Kontraktori duhet të sigurojë uniformën dhe pajisjet mbrojtëse në punë për personelin e tij.
- Kontraktori duhet të verë në dijeni me shkrim Drejtorinë e Prodhimit të shoqërisë Albpetrol Sh.A., të paktën 1(një) javë më parë përsa i përket punimeve periodike për mirëmbajtjen e mjetit.

e) Kontraktori ka për detyrë dhe të plotësojë kushtet si më poshtë:

- X) Kryerjen e Proceseve të Operacioneve Hidrokarbure për eliminimin e avarisë në pusin Ca-58 të vendburimit Cakran-Mollaj të shoqërisë Albpetrol Sh.A., Punimet do të kryhen në zbatim të programit të punës të hartuar nga Qendra e Prodhimit të Naftës Fier dhe të miratuar nga Drejtoria e Prodhimit dhe Drejtoria e Gjeologjisë.
- XI) Kontraktori duhet të caktojë një person kontakti i cili në bashkëpunim me komisionin e mbikqyrjes së punimeve të ngritur nga QPN Fier duhet që:
- Planifikojë dhe zbërthejë programin e remontit së bashku me komisionin e mbikqyrjes së punimeve të ngritur nga Q.P.N Fier dhe Supervizorin e ndjekjes së ecurisë së kontratës emëruar nga Albpetrol Sh.a.
 - Është përgjegjës për sigurimin e punimeve me mjetet e sondës dhe të sigurohet që të ndiqen procedurat e punës për parandalimin e aksidenteve në punë.
 - Të sigurojë ç'do relacion ose raport që kërkohet nga komisioni i mbikqyrjes së punimeve të QPN Fier.
 - Të dorëzojë te komisioni i mbikqyrjes së punimeve të QPN Fier raportin e përfundimit të punimeve për ç'do punim sapo ai ka përfunduar.
- XII) Kontraktuesi menjëherë pas nënshkrimit të kontratës do të fillojë punën për kryerjen e shërbimit në pus për eliminimin e avarisë në pusin Ca-58.
- XIII) Për pusin në të cilët kontraktori do të kryejë operacione hidrokarbur, do të njoftohet me shkrim nga Q.P.N Fier (Akti i dorëzimit të sheshit të pusit). Urdhëri nga qendra do të lëshohet mbi bazën e një programi pune hartuar po nga vetë Q.P.N Fier dhe miratuar nga Drejtoria e Prodhimit dhe Drejtoria e Gjeologjisë.
- XIV) Për ç'do pus ku kontraktori do të kryejë shërbimin, linja elektrike dhe të tjera do të sigurohen nga Q.P.N. Fier, po ashtu dhe Qendra do të pajisë pusin me grykë të rregullt pusi.

XV) Kontraktori për ç'do proces pune që do të kryejë duhet domosdoshmërisht ta evidentojë atë në dokumentacion teknik të rregullt. Në përfundim të kryerjes të cdo procesi pune për eliminimin e avarisë në pusin Ca-58, duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës:

- **Kopje të programit të punës** të përpiluar nga Qendra e Prodhimit përkatëse dhe miratuar nga Drejtoria e Prodhimit dhe Drejtoria e Gjeologjisë & Studimit.
- **Urdhër pune me shkrim** (Urdhër i dorëzimit të sheshit të pusit) lëshuar nga Q.P.N. Fier. Ky dokument duhet të jetë i firmosur nga të gjithë pjestarët e komisionit të mbikqyrjes të punimeve të Qendrës përkatëse.
- **Lista e kontrollit të sondës së shërbimit** plotësohet vetëm një herë në fillim të punimeve. Duhet të jetë i firmosur nga minimumi 1 pjestar i komisionit të mbikqyrjes të punimeve të Qendrës përkatëse. Ky dokument duhet të plotësohet me bojë të freskët (Jo fotokopje).
- **Deklarata e sigurisë në sheshin e pusit** është një dokument që plotësohet dhe firmoset nga kushdo që hyn në sheshin e pusit për herë të parë. Ky dokument duhet të plotësohet me bojë të freskët (Jo fotokopje).
- **Takimi paraprak i sigurisë për punë dhe vlerësimi i rreziqut** plotësohet për ç'do ditë që brigada e remontit punon në pus. Duhet të jetë i firmosur nga minimumi 1 pjestar i komisionit të mbikqyrjes të punimeve të Qendrës përkatëse. Ky dokument duhet të plotësohet me bojë të freskët (Jo fotokopje).
- **Raport pune** (Ditari i punimeve) plotësohet për ç'do ditë që brigada e remontit punon në pus. Këtu shënohet e gjithë ecuria e punimeve gjatë ditës. Duhet të jetë i firmosur nga minimumi 1 pjestar i komisionit të mbikqyrjes të punimeve të Qendrës përkatëse ose Supervizori i ndjekjes së ecurisë së kontratës. Ky dokument duhet të plotësohet me bojë të freskët (Jo fotokopje).
- **Kartelat e matjes së tubove e purtekave.** Ky dokument duhet të plotësohet me bojë të freskët (Jo fotokopje).
- **Libreza e masave.** Ky dokument duhet të plotësohet me bojë të freskët (Jo fotokopje).

XVI) Urdhëri i Punës, mbikqyrja, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera nga subjekti privat, do të bëhet nga komisioni i ngritur nga Q.P.N Fier.

XVII) Likujdimi i Kontraktorit do të bëhet vetëm në bazë të Situacionit përfundimtar të mbajtur për pusin Ca-58 të konfirmuar nga komisioni përkatës i mbikqyrjes të punimeve dhe miratuar nga Supervizori i kontratës caktuar nga "Albpetrol" Sh.A.

XVIII) Likujdimi financiar i Kontraktorit nuk do të bëhet në rastet kur pusi nuk vihet në shfrytëzim për arsye të cilësisë së dobët të punimeve të kryera nga ai në zbatim të Programit të Punës dhe të konfirmuara nga Supervizori i kontratës dhe komisioni i mbikqyrjes së punimeve të Qendrës përkatëse.

f) Autosonda

- Duhet të jetë e pajisur me kullë dhe lëvizja e saj të bëhet nëpërmjet gomave.
- Duhet të ketë kapacitet ngritës ≥ 80 ton (800 kN) .
- Duhet të jetë e pajisur sistem ajri për hapjen dhe mbylljen e kunjave (Slips) mbështetëse të tubove.
- Duhet të jetë e pajisur me sistem hidraulik. Panel hidraulik komande për hapje-mbyllje të sistemit të preventorëve (BOP, Anular BOP). Me dalje për lidhjen e kyçeve hidraulike dhe rrotorit hidraulik .
- Duhet të ketë vinç hidraulik për ngritje pajisje me kapacitet ≥ 2.5 ton.
- Duhet të jetë e pajisur me sistemin e fikjes të emergjencës.
- Sistemi i shkarkimit të gazrave duhet të jetë e pajisur me parandalues shkëndije dhe kështu e pajisur për mbrojtjen nga shpërthimi i zjarrit.

- Sonda duhet të ketë me vete platformën e punës për punëtorët dhe skelë për tubot dhe pajisjet që ndodhen në sheshin e pusit .
 - Sonda duhet të jetë e pajisur me tester i kompletuar me tubo gomë të presionit të lartë ≥ 3000 psi, i cili të realizojë qarkullimin për pastrimin e pusit përgjatë operacioneve të ndryshme të remontit.
 - Sonda duhet të jetë e pajisur me rrotullues hidraulik, me qëllim për të siguruar momentin rrotullues të instrumentit të remontit nëntokësore për frezime në trungun e pusit.
 - Duhet të jetë e shoqëruar me pompë presioni ≥ 200 atm e cila të realizojë qarkullim e fluidit në trungun e pusit, për mbytjen, larjen e pusit ose frezime në trungun e pusit.
 - Duhet të ketë me vete kabinë me material të lehtë në shesh të pusit për punëtorët dhe supervizorin e Albpetrol.
 - Duhet të jetë e pajisur me elevatore për tubing nga $2 \frac{3}{8}"$ deri në $3 \frac{1}{2}"$, (Të gjitha llojet e elevatorëve për të gjitha dimensionet e tubove).
 - Duhet të jetë e pajisur me elevator për purteka nga $\frac{3}{4}"$ deri në $1 \frac{1}{4}"$, (Të gjitha llojet e elevatorëve për të gjitha dimensionet e purtekave).
 - Duhet të jetë e pajisur me kyçe hidraulike për tubing nga $2 \frac{3}{8}"$ deri në $3 \frac{1}{2}"$, (Të gjitha llojet e kyçeve për të gjitha dimensionet e tubove).
 - Duhet të jetë e pajisur me kyçe hidraulike për purteka nga $\frac{3}{4}"$ deri në $1 \frac{1}{4}"$, (Të gjitha llojet e kyçeve për të gjitha dimensionet e purtekave).
 - Duhet të jetë e pajisur me peshkatore për tubing nga $2 \frac{3}{8}"$ deri në $3 \frac{1}{2}"$, (Të gjitha llojet e peshkatoreve për të gjitha dimensionet e tubove).
 - Duhet të jetë e pajisur me peshkatore për purteka nga $\frac{3}{4}"$ deri në $1 \frac{1}{4}"$, (Të gjitha llojet e peshkatoreve për të gjitha dimensionet e purtekave).
 - Duhet të jetë e pajisur me pajisje fshirëse për tubing nga $2 \frac{3}{8}"$ deri në $3 \frac{1}{2}"$, (Të gjitha llojet e fshirësive për të gjitha dimensionet e tubove).
 - Duhet të jetë e pajisur me pajisje fshirëse për purteka nga $\frac{3}{4}"$ deri në $1 \frac{1}{4}"$, (Të gjitha llojet e fshirësive për të gjitha dimensionet e purtekave).
 - Duhet të jetë e pajisur me kunja pneumatike (Slips) mbështetëse për tubing nga $2 \frac{3}{8}"$ në $3 \frac{1}{2}"$, (Të gjitha llojet e kunjave për të gjitha dimensionet e tubove).
 - Duhet të jetë e pajisur me stampa të të gjitha dimensioneve për marrjen e gjurmëve të purtekave dhe tubove brenda tubove me dimensione nga $2 \frac{3}{8}"$ deri në $3 \frac{1}{2}"$ dhe brenda kollonave të shfrytëzimit me dimesione nga $5"$ në $8 \frac{5}{8}"$.
 - Duhet të jetë e pajisur me olivo të të gjitha dimensioneve, për punime në kollona me dimesione nga $5"$ deri në $8 \frac{5}{8}"$.
 - Duhet të jetë e pajisur me gërryerëse të të gjitha dimensioneve, për punime në kollona me dimesione nga $5"$ deri në $8 \frac{5}{8}"$.
 - Duhet të jetë e pajisur me preventore (B.O.P) :
 - Preventor dy shkallësh për tubo me mbyllje unazore dhe qorre për presion ≥ 5000 psi preventori duhet të përputhet me flanaxhë mbështetëse $7 \frac{1}{16}"$ dhe të sigurojë mbyllje unazore për tubo nga $2 \frac{3}{8}"$ deri më $3 \frac{1}{2}"$.
 - Preventor për purteka me presion $\min \geq 3000$ psi .
 - Duhet të jetë i pajisur me Coil-tubing.
4. Kushtet e punës
- Temperatura e ambientit: 20°C deri 45°C
 - Maksimumi lageshtise relative $\leq 75\%$
5. Parametrat kryesore teknike

-
- Fuqia e instaluar: 565 kW (768HP), fuqia e energjsë për njesi
 - Forca maksimale e ngritjes: 450 kN (100000 lbs)
 - Shtytja maksimale e poshtme: 225 kN (50000 lbs)
 - Shpejtësia maksimale e ngritjes: shpejtësia e larte e pajisjes: 52 m/min(170.9 ft/min)
 - Shpejtësia maksimale e ngritjes: shpejtësia e ulet e pajisjes: 23.7 m/min(77.9 ft/min)
 - Presion maksimal i operimit: 105 MPA(15000 psi)
 - Bobina mund të mbajë 4500 m ose 1.75 ‘’ tubo. Koka e injektorit mund të tërheq 100 k lbs dhe të këputet 50 K lbs.

6. Parametrat e BOP

- Presioni i punës: 69.0MPA (10000 psi)
- Specifikimi i tubit te naftës: 1.75’’
- Duhet të jetë e pajisur me fikëse zjarri 14 kg ABC.
- Duhet të jetë e pajisur me kutinë e ndihmës së shpejtë.
- Duhet të jetë e pajisur me detektor gazi H₂S.
- Duhet të jetë e pajisur me pajisje speciale kundërgazi, aparat frymëmarrje të kompletuar me bombola oksigjeni.
- Duhet të jetë e pajisur me rrip sigurimi për ngjitjet në lartësi.
- Duhet të jetë e pajisur me urë për sistemimin e tubove dhe purtekave për minimalisht 3000 ml tubing 2 7/8’’ TS.

Për autosondën si dhe për pajisjet ndihmëse të autosondave duhet të paraqiten çertifikatat e inspektimit (testimit) nga fabrika prodhuese ose nga institucione të licensuara. Certifikatat duhet të jenë në standartit API ose ISO.

Për pompat me gjithë pajisjet shoqëruese, si dhe autosonda që do të kryejë punimet në puset e V.b. Cakran-Mollaj të Shoqërisë “Albpetrol” Sh.A., duhet të paraqiten certifikatat e inspektimit (testimit) nga fabrika prodhuese. Çertifikatat duhet të jenë në standartit API, ISO ose çdo standart i barazvlefshëm përfshirë standartet Shqiptare.

Afati i punimeve: 2 (dy) muaj nga koha e fillimit të punimeve.


Shënim: Në rastet kur gjatë punimeve në pus nga kontraktori do të dalin problematika të paparashikuara në Programin e Punës, do të behet shtesë Programi Pune dhe shtyrje afati të punimeve i hartuar nga Q.P.N. Fier dhe i miratur nga Dega Teknike në administratën e Albpetrol Sh.A..

Operacionet që do të kryhen në pusin Ca-58


Nr	Operacionet	Nr. i Proçeseve
1	Përgatitja e sheshit të pusit për ardhjen dhe instalimin e sondës si dhe pajisjeve të saj. Përgatitja e grykës së pusit së bashku me valvulat dhe linjat e duhura të mbytyes së pusit dhe fakelit Përgatitja e linjave të tjera sipërfaqësore për në depo, apo grupin e prodhimit. Vendosja e pajisjeve të sigurisë si drejtues erë, pika e grumbullimit Mobilizimi i sondës, pajisjeve dhe personelit sipas planit të përcaktuar Ngritja e kullës dhe instalimi i pajisjeve aneks të sondës Instalimi i pompës së sondës ose agregatit për qarkullim ose mbytyjen e pusit Instalimi i preventorit së bashku me fllanxhën e punës mbi grykën e pusit dhe testimi për funksionalitetin e tij. Testimi me presion i preventorit në 350 bar për 5 min dhe 200 bar për 10 min. Shkarkimi i presioneve.	1
2	Nxjerrja e tubove pompë kompresor nga pusi 177 copë Ø 2 7/8" TS + 73 copë Ø 3 1/2" TS dhe matja e tyre, si dhe të furnizohet pusi me tubo Ø 2 7/8" PK në gjatësi të nevojshme për arritjen e fundit të pusit në H = 3047 m. (Furnizimi me tubo Ø 2 7/8" PK do të bëhet nga Albpetrol Sh.A.).	1
3	Ulja e stampës për të verifikuar thellësinë e kokës së tubos të mbetur në pus, si dhe konfiguracionin e pjesës së sipërme.	1
4	Ulja me tubo e dy pastruesve (scrapers) njëkohësisht për pastrimin e mureve të brendshme të kollonës së shfrytëzimit Ø 6 5/8" dhe Ø 5" dhe qarkullim për pastrimin e mbetjeve asfaltene të pusit.	1
5	Të kryhen matje gjeofizike për kontrollin e integritetit të kollonës së shfrytëzimit Ø 6 5/8" dhe 5".	1
6	Mobilizimi dhe instalimi pranë grykës së pusit të pajisjeve të Coil Tubing. Instalimi dhe ulja me ngadale me anë të coil tubing të prerës së metalit dhe peshkatores kambanë Ulja me ngadale në metrat e fundit që mendohet se pajisja prerëse është duke hyrë brenda tubove në pus.	1
7	Prerja me qarkullim i tubos së bashku me pecon dhe sjellja e tyre lartë	1
8	Ulja e frezës me anë të coil tubing për frezimin me qarkullim të jet pompës dhe ankoruesit Pas frezimit ulja më poshtë me qarkullim me coil tubing në ball të hapur. Kapja e fundit të pusit De-mobilizimi i mjeteve coil tubing, pajisjeve dhe personelit	1
9	Mobilizimi dhe instalimi pranë grykës së pusit të pajisjeve të karrotazhit	2
10	Kryerja e matjeve për integritetin e kollonës, gurit të çimentos si dhe matjeve Karbon-Oksigjen	1
11	De-mobilizimi i mjeteve të karrotazhit, pajisjeve dhe personelit	1
12	Do të instalohet dhe ulet në pus kompletimi i tubove pompë-kompresor për vënien e pusit në shfrytëzim.	1
13	Vënia e pusit në zhfrytëzim dhe monitorimin e parametrave	1
13	De-mobilizimi i sondës, pajisjeve dhe personelit	1

SITUATA AKTUALE E PUSIT Ca-58 PAS KRYERJES SË PUNIMEVE TË REMONTIT NË VITIN 2018

Kompletimi								
Kollona	Diametri	Thellësia (m)	Seksioni Çimentos	Intervali (m)	Grada	Trashësia e faqes (mm)	Pesha (lbm/ft)	Pesha (Kg/ml)
Konduktori	16"	51 m	51 m	0 - 51	J-55	10.59	75	111.59
Kollona e shfrytëzimit	6 5/8"	1225.95 m	200 m	0-582.85	N-80	8.94	24	35.71
				582.5 - 1225.95 (643.1 m)	N-80	10.59	28	41.66
Kollona e shfrytëzimit	5"	1903 m (1076.78 - 2980 m)	500 m	1076.78 - 2676.58 (1599.8 m)	N-80	7.52	15	22.32
				2676.58 - 2980 (303.24 m)	N-80	9.19	18	26.78



PUSI CAKRAN - 58



Thellësia :

- Projekt $H = 3100\text{ m}$
- Fakt $H = 3047\text{ m}$

Data e fillimit të shpimit: 27.05.88

Data e përfundimit të shpimit: 17.11.1988

KONSTRUKSIONI

1. Konduktori:

- $\varnothing = 16''$
- $H = 51\text{ m}$
- $0 - 51\text{ m}$, J-55 # 54.5 lb/ft

2. Kollona e Shfrytëzimit

- $\varnothing = 5'' \times 6^{5/8''}$
- $H = 2980\text{m}$
- $0 - 582.85\text{m}$, $6^{5/8''}$, N-80 # 24lb/ft
- $582.85 - 1225.95$, $6^{5/8''}$, J-55 # 28lb/ft
- $1076.78 - 2676.58, 5''$, N-80 # 15lb/ft
- $2676.58 - 2980, 5''$, N-80 # 18lb/ft

THELLËSIA TOTALE = 3047m

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të paslyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1. Kapaciteti ligjor plotësohet duke dorëzuar dokumentat sipas Kriteve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se: 40 % e fondit limit objekt prokurimi, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

Si dëshmi për pervojën e mëparshme kerkohen të paraqiten:

Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të furnizuara.

OSE

Ne rastin e pervojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të furnizuara.

2.3.2. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me çertifikatë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ku është akredituar ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA). Çertifikatat që kerkohen duhet të jenë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit:

Operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in Çertifikatë ISO ose ekuivalente dhe duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit:

- ISO 9001:2015 (ose ekuivalente)
- OHSAS 18001-2007 ose ISO 45001-2018 (ose ekuivalente)
- ISO 14001-2015 (ose ekuivalente)

2.3.3. Operatori ekonomik ofertues të paraqesë një deklaratë nepermjet se ciles garanton AK-në, se merr persiper sigurimin e kushteve të sigurisë në punë për të gjithë stafin e angazhuar për zbatimin e kësaj kontrate, duke ciluruar AK nga cdo përgjegjësi në rastin e aksidenteve në punë.

2.3.4. Operatori ekonomik ofertues, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 10 (dhjetë) persona**.

Për të vërtetuar këtë duhet të paraqitet:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për numrin e punonjësve të siguruar për tre muajt e fundit.

Shënim: Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr. 10

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

2.3.5. Operatori ekonomik ofertues, duhet të ketë Drejtuesin Teknik me profesion Inxhinier Nafte, për këtë të paraqiten :

- Diploma e shkollës së lartë.
- Çertifikata e Lejes Profesionale për aktivitetin e kerkimit, prodhimit e zhvillimit të lendeve hidrokarbure, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturs dhe Energjisë.
- Listepagesat e shoqërsë për tre muajt e fundit në të cilat inxhinieri i sipërcituar duhet të figurojë.

Shënim: Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.10

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

2.3.6. Operatori ekonomik ofertues, të ketë pjesë të stafit, një specialist të certifikuar për mbikqyrjen dhe kontrollin e operacioneve të remontit dhe përdorimin e pajisjeve të kontrollit (BOP), të puseve.

Për të vërtetuar këtë duhet të paraqiten:

- Certifikata përkatëse.
- Listepagesat e shoqërisë për të paktën tre muajt e fundit në të cilat specialisti i sipërpermendur duhet të figurojë.

Shenim: Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr. 10.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

2.3.7. Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë të paktën 1(një) autosonde sipas kërkesave në specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor, për eliminimin e avarisë me autosonde në pus, në pronesi apo të marre me qera të vërtetuar si më poshtë :

- **Pronesia** e autosondes të vërtetohet duke paraqitur lejen e qarkullimit, siguracion të vlefshëm, akt kolaudimi të vlefshëm.
- **Marrja me qira** ose huapërdorja e autosondes, do të pranohet vetëm nëse kontrata/t e qiramarrjes ose të huapërdorjes janë të lidhura para noterit, me afat vlefshmerie i cili përfshin afatin e zbatimit të kësaj kontrate për këtë shërbim dhe të shoqëruara me dokumentacion (lejen e qarkullimit, siguracion të vlefshëm, akt kolaudimi të vlefshëm).
- Për autosondën duhet të paraqitet gjithashtu çertifikata e inspektimit (testimit), ku specifikohet kapaciteti ngritës ≥ 80 Ton, të jetë sipas standartit API , ISO ose çdo standart ekuivalent përfshirë standartet Shqiptare.

Shenim: Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr. 10.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën e kryerjes së verifikimit në vend të mjeteve autosonde shërbimi me kullë me kapacitet ngritës ≥ 80 Ton dhe të pajisjeve të tjera për të konstatuar nëse ato përmbushin kërkesat teknike të kërkuara prej tij.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 10.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i>_____
Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i>_____
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i>_____
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i>_____
Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i>_____
Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij,

aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime _____ nëse _____ vlerësohet _____ e
nevojshme _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, Deklaroj Se:

